



Monitorimi për muajin nëntor 2017 mbi ndjekjen e Kapitullit 23 – gjqësori, lufta kundër korrupsionit dhe të drejtat themelore

I GJYQËSORI

Reforma në gjyqësor

Në seancën e 40 më 28.11.2017 Qeveria e miratoi Strategjinë për reforma në sektorin e gjyqësorit (2017-2022) së bashku me Planin aksionar, më pas ato do të hyjnë edhe në procedurën e Kuvendit për miratim,¹ e cila është dhënë tri herë për mendim te Komisioni Evropian. Në atë seancë, Qeveria e ka shqyrtuar dhe e ka miratuar Propozim-ligjin për amnisti, duke e obliguar Ministrinë e Drejtësisë që ta përpunojë tekstin e propozimit, si tekst i cili miratohet me procedurë të rregullt dhe ta parashikojë dispozitën me të cilën do të saktësohet se ai ka të bëjë me veprat penale të vendosura me të, të kryera deri më 20.09.2017. Qeveria e theksoi nevojën e organizimit të debatit publik dhe e obligoi Ministrinë të dorëzojë tekst të spastruar dhe të harmonizuar, pasi të kalojë periudha e konsultimeve dhe debateve të hapura.²

Në takimin e Eurokomesarin për zgjerim dhe politikë fqinjësore Johanes Han, ministri i drejtësisë, Bilën Salija ka referuar për aktivitetet e ndërmarra në raport me dinamikën e plotësimit të prioritetëve urgjente të reformave të parapara në planin e Qeverisë “3-6-9”.³

Midis të tjerash, në Regjistrin e vetëm elektronik nacional të dispozitave (RVEN) gjatë nëntorit janë dorëzuar edhe propozim-ligjet në lidhje me reformën gjyqësore të cilat lidhen me Këshillin Gjyqësor, Avokatin e Popullit, procedurën penale, Prokurorinë Publike, Këshillin e Prokurorëve Publikë, si dhe propozim-ligjin për shërbim të prokurorisë publike.⁴

Pavarësia

Gjykata Kushtetuese e shfuqizoi Ligjin për përcaktim të llojit dhe matje të lartësisë së dënimit

Gjykata Kushtetuese shpalli vendimin me të cilin shfuqizohet Ligji për përcaktim të llojit dhe matje të lartësisë së dënimit, me arsyetim se ky ligj e cenon seriozisht në pavarësinë pushtetit gjyqësor dhe e

¹http://www.pravda.gov.mk/novost_detail.asp?lang=mak&id=1410

²<http://vlada.mk/node/13793>

³http://www.pravda.gov.mk/novost_detail.asp?lang=mak&id=1408

⁴https://ener.gov.mk/default.aspx?item=pub_regulation



shkel parimin e ndarjes së pushtetit. Me këtë ligj është bërë përzierje e pushtetit ligjvënës dhe gjyqësor i cili duhet të jetë i pavarur. Përveç kësaj, në këtë vendim theksohet se ligji është në kundërshtim me vlerësimin e lirë, të paraparë me ligj, të dëshmime dhe bindjes gjyqësore, e cila me këtë ligj është formalizuar, ndërsa gjatë kësaj nuk i është kushtuar kujdes individualizimit të dënimit. Për gjykatësit kushtetues, zgjidhjet e përmbajtjes në këtë ligj nuk janë në përputhje me Kushtetutën e RM-së dhe sundimin e të drejtës, për të cilën flet edhe analiza⁵ e profesorëve për të drejtë penale, Buzharovska dhe Nanev, të cilës i drejtohet edhe referati i Gjykatës.⁶

Këshilli Gjyqësor zgjodhi kryetarë të Gjykatës Penale, kryetarë dhe gjykatës në disa gjykata

Këshilli Gjyqësor i Republikës së Maqedonisë lajmëroi se në seancën e 266 ka marrë vendim për zgjedhje të gjykatësit Ivan Xholev për kryetar të ri të Gjykatës Themelore Shkup 1 Shkup.⁷ Xholev dha deklaratën solemne para Kryetarit dhe anëtarëve të KGJRM-së.⁸

Në seancën në vijim, seancën 267, Këshilli ka marrë vendime për zgjedhje të kryetarëve të rinj Gjykatës së Apelit në Shtip (Nake Georgiev), si edhe të gjykatave themelore në Kumanovë (Snezhana Manev),

⁵Kjo analizë ishte përgatitur në suazat e projektit “Rrjeti 23+” dhe gjendet në këtë link

http://www.merc.org.mk/Files/Write/00001/Files/Network23/studies/Analiza_Primena-na-ZOVOVK_SPPMD-Juni-2017.pdf

⁶<http://www.ustavensud.mk/domino/WEBSUD.nsf>

⁷http://www.vsrn.mk/wps/portal/ssrm/sud/vesti/ac33d32d-06ae-427c-95d6-dbb2e31c0e4d!/ut/p/z1/rVNNU9swFPwtHHyU9W3LvRloSNMmwFCXWBePbMuOC_7AFjb011fpdKaTQJMyVlc3s2_fvn0rKOEaykaNValM1Tbq3tax9BLvgjEkPqMvYnEeoDBidHZ99RUzn8HbXcAFvhQWcBl5wXxGoohCebj_G5RQZo3pzAbGQztqk9R3Dhoecwd1baZNoxw06sFUDIIzPtkIOUCe0oARPwMBzz2QpynRFGdIs3xL12VVDmOac8YyTgDNmQeYjykQxA8A23GqVZEplp9-S_1beWjv7wQ_e4_AJDH7JPHRshdjpcOL6Cs0tqdstpFrsCUUyl8zggTvoe3Fwybll0Syl4Xute9-9jbw26M6YYPDnLQNE1u2bbblvXaztnbQay2bdjBwwYuEsV3e_6Pscj7zrbKpmlfimtZMrTtjPScYNW1f2ydzvPE2lmbvwp5_M_zahNuzZXL1CcZ4WzRDcpAg-YVWpXYpoz7myAOCYitJ-IUNI01YgYkKOPMDxQmMyRt3OLzAir_Toip0_jvpF8fia5NSfX94kKH9w21j9JMNyf_4xJaX9MuzpU1gp8wGVE3RwvU_tXZ1VAV6XIG7Yml4ysss6OT9d8XEF4sX443QFZPo8hScnPwFVUIhO/dz/d5/L2dBISEvZ0FBIS9nQSEh/?urile=wcm%3Apat h%3A%2Fsovet_mk%2Fsud%2Fpocetna%2Fvesti%2Ffac33d32d-06ae-427c-95d6-dbb2e31c0e4d

⁸http://www.vsrn.mk/wps/portal/ssrm/sud/vesti/857d19cc-9e44-42ba-965d-58baefaf75a5!/ut/p/z1/rVNNc5swFPwtOXAU-kBCoJeS1HHd2kkmpTG6MAIEpgkFAQWS_vrKnc507KR2M6lub2bfvn37VIDCNZSNGqtSmapt1L2tY-kn_gWISHxGX8TiPEBhRL3Z9dVXTDmFt7uAC3wpLOAy8oP5jESRB-Xh_m9QOqk1pjMbGA_tqE1S3zloeMwd1LWZNo1y0KgHUzIIMJ7jIMtAoCkFIKQKBD7LAROp0oUqOFNsS9dIVQ5jpEjOkUIA-7IFaxyAtEgZ8EVBVJ5iC2b78l_q28pHf3kh-t1_ACCP2SePjZC7HC8dXkZpbU7ZbWLXIE95hHhM0qo4D7eXjBsUk-UUPa60L3u3cfeHnzjTdd8cJCDpmlly7Yt77WbtbWDXmvZtIOB610kjO3y_l-yy_mMW2UfMQvFNbmZW3fGsk8watq-tlm6eeNtLMHed3_Zvi1Cbdny-TqE4zxtmiG5CBB8gutSu161OOYIR8ID_vAeAgPEMFJiogFEeKEZgTN64w-EFVuydFh2h5--kXxyLr01K9f3hQYb2D7eN0U82JP_jE1te0i_PljaBnTibUDVFC9f_1NrVUS285wrcFUvDUlBWyfnpio0rEC_GH6crINPnKT_w5-QkXFO2V/dz/d5/L2dBISEvZ0FBIS9nQSEh/?urile=wcm%3Apath%3A%2Fsovet_mk%2Fsud%2Fpocetna%2Fvesti%2F857d19cc-9e44-42ba-965d-58baefaf75a5



Tetovë (Hasan Asani) dhe Resnjë (Emel Krani Ali), kurse kandidati për kryetar në Gjykatën Themelore Dibër nuk i mori shumicën e votave në Këshill.⁹

Gjykatësi Afrim Fidani, i cili më 25.11.2017 duhej të vendoste se a mund të përdoren xhirimet në internet të kabinetit të kryetarit të atëhershëm të Komunës së Strumicës, Zoran Zaev, si dëshmi në rastin “Mito”, është zgjedhur si gjykatës në Gjykatën e Lartë. Nga Gjykata e Apelit Shkup për mediat pohuan se gjykatësi Fidani nuk do të vendosë për xhirimin, kurse mandej do të përcaktohet se a do ta mbajë seancë publike për “Mito” ndonjë gjykatës tjetër apo ajo do të shtyhet.

Në këtë seancë anëtarët e Këshillit e zgjedhën gjykatësen Tanja Mileva si gjykatëse në rajonin penal në Gjykatën e Apelit Shkup, kurse për lëndë qytetare i mbështetën kandidaturat e Zoran Gerasimovskit dhe Alija Elezit. Aleksandar Kambovski është gjykatës i ri në Gjykatën e Apelit Manastir, kurse do të shpallin edhe shpallje për pozitat të cilat mbetën të paplotësuara për gjykatës në Gjykatën e Apelit Shkup dhe në Gjykatën e Lartë. Sipas kryetarit Karaxhovski vendet e paplotësuara janë për shkak të faktit se kandidatët nuk i kanë plotësuar kushtet e nevojshme.

Përndryshe, njëzet prej 56 gjykatësve gjithsej në gjykatën penale në Shkup janë paraqitur për katër pozitat e shpallura në Gjykatën e Apelit Shkup, kurse ish u.d. Kryetarja e kësaj gjykate Tatjana Mihajlova, e cila e gjykon ish-kryeministrin Gruevski për incidentin në Komunën Qendër, ka konkurruar për gjykatëse në Gjykatën e Apelit Manastir, si dhe për kryetare të Gjykatës së Resnjës, pas kësaj gjatë seancës ajo i tërhoqi të dyja kandidaturat.¹⁰

Paanësia dhe përgjegjësia

PTHP ndjek 36 persona, midis të cilëve edhe 6 deputetë, për “Rrezikim terrorist të rendit kushtetues” në lidhje me dhunën Kuvend – Gjykata Penale ka përcaktuar masa kujdesi për 19

Në fund të muajit, PTHRM e ka informuar opinionin se PTHP për Ndjekje të Krimin të Organizuar dhe Korrupsionit (PTHPNKOK) pas ndërmarrjes së të gjitha veprimeve për përcaktimin e fakteve mbi ngjarjet të cilat kanë ndodhur më 27 prill 2017 në Kuvendin e RM-së e ka përfunduar procedurën parahetimore. Pas shqyrtimit dhe analizës së materialit të mbledhur dëshmuës PTHPNKOK ka miratuar Urdhër për

⁹http://www.vsrn.mk/wps/portal/ssrm/sud/vesti/f07f90a0-0886-4d59-b63e-32130239134c/!ut/p/z1/tVPLUuMwEPwaH2WNLNmS9-ZiN6TCI1BgEutC-SEnBiwZW9jLfv0qJ4rA8igWXVQqTffMdM9giddY6nxsNrltjM7v3DuT0XV0yBillzgWi58xJCmjs_OzS8I4w6vnAYdkKVzAMo3i-SxIU4rI2_grLLEste3sFmeDGZW9bm89GB4qDzpTKqtzD0Y12MaDGngdQw4IhIgQq8IYFRFViAaEQkBjQIm5o-vKpsKzqGtaKe6-w6BCTOQUFYoLxEmZU8ZooUq1X_7L-nblwz9OAg4v3wtZYnkUrT-VrQ--IDSkgYhCFjDBI7ITONEFFRsse1WrXvX-Q-9031rbDT888GCaJn9jzOZO-aVpPXgNsjWDxevnkThzvfGn3pbzGXe9_SJhIs6Di7krfmzUhfnt-tZZffJ6RzBXoY99Wwbkixnepi8Nv5eef5F-8d7oOx-D_uTgxPnY5XaLGI0bvP7QkDtoc3N_LxO3O0Zb9du5_z-Wp2vTVtBHpP8cqXKFuM0XdbtQSF210oMfwHgmTZx/dz/d5/L2dBISEvZ0FBIS9nQSEh/?urile=wcm%3Apath%3A%2Fsovet_mk%2Fsud%2Fpocetna%2Fvesti%2Ff07f90a0-0886-4d59-b63e-32130239134c

¹⁰<http://24vesti.com.mk/razreshuvanje-i-imenuvanje-sudii-i-pretsetateli-na-sudovi>



zbatimin e procedurës hetimore kundër 36 personave për shkak të dyshimit të bazuar për kryerje të veprës penale.¹¹ Sipas mediave, Prokuroria ka kërkuar masë paraburgim për të 36 personat.¹²

Gjykata Themelore Shkup 1 Shkup shpalli se duke vepruar sipas propozimit të prokurorisë para gjykatësit në procedurë të mëparshme më 28.11.2017 janë thirrur 26 persona dhe më pas janë marrë vendime me të cilat personat M.Ç., O.P., I.D., O.R., G.A., V.T., D.L., I.C., B.I., I.Ç., I.S., dhe V.M. gjykatësi në procedurë paraprake e ka pranuar propozimin dhe u ka përcaktuar masë paraburgim në afat prej 30 ditësh, ndërsa S.M., G.Gj., M.P., E.D.B., B.D., V.J, u ka përcaktuar masë arrest shtëpiak.¹³

Njëkohësisht, është shpallur se personat të cilët janë përfshirë në propozim, kurse në moment e zbatojnë funksionin deputet gjykatësi në procedurë të mëparshme do të veprojnë për marrje të vendimit për propozimin e Prokurorisë pasi të vendoset sipas kërkesës për marrje të imunitetit të tyre. Ndërkohë, Komisioni për Çështje të Rregullores, Mandatit dhe Imunitetit mbajti seancë ku u vendos njëzëri marrja e mandateve të deputetëve.¹⁴

U shfuqizua vendimi për “Monstrum”, lënda kthehet për rivendim

Gjykata e Lartë vendosi se i ka miratuar kërkesat e ankesës së mbrojtjes në lëndën e njohur në publik si “Monstrum”, kështu që e shfuqizoi vendimin e shkallës së dytë dhe të parë duke e kthyer lëndën për rivendim para gjykatës së shkallës së parë.¹⁵ Të akuzuarit në këtë rast gjenden në arrest që në vitin 2013.

¹¹<http://jorm.gov.mk/?p=4416>

¹²<http://www.sudstvo.mk/2017/11/28/%D1%84%D0%BE%D1%82%D0%BE-%D0%BE%D0%B1%D0%B2%D0%B8%D0%BD%D0%B8%D1%82%D0%B5%D0%BB%D1%81%D1%82%D0%B2%D0%BE%D1%82%D0%BE-%D0%BF%D0%BE%D0%B1%D0%B0%D1%80%D0%B0%D0%BB%D0%BE-%D0%BF%D1%80%D0%B8%D1%82%D0%B2/>

¹³http://www.vsrn.mk/wps/portal/osskopje1/sud/vesti/41532aca-6228-4fdc-aed8-e2b3b9828999!/ut/p/z1/rVJdT8lwFP01e2x66cbWPRYQxSJAo71hXRFUGXdyGUov97yZKJxYPC-3eR83HNzMMdLzJV05FpoWSqxNXvE3ZUboA7Qe3igs-cesAF4dO4zgiGHwzZAMATM2_kvmGOeKF3pDY6qQ7yVyap4s6A-pBZUZZJpJSxoslpLC5xO1yYiEcglhClnTxMkspSijMR27FNCFd8_61WJTHFOFTq8FPB8P_wyDAYfX4JExsL7spiOhh6wxaDTZfSJTJn5YSOzl16ocl-YI8_-mGD0w-FbiHH3RodW-dmde6P8-FJHTAnJftKfrl2s0BskVV7i5VXahipfdzvOTMIKpbN3jZf_OrKqWBTU_kDq1HtEQT-mx3lehLT-BBoe4P8!/dz/d5/L2dBISEvZ0FBIS9nQSEh/?urile=wcm%3Apath%3A%2Fpublic_mk%2Fsud%2Fpocetna%2Fvesti%2F41532aca-6228-4fdc-aed8-e2b3b9828999

¹⁴<http://www.sobranie.mk/materialdetails.nspx?materialId=2f6ebb9c-af48-459f-8489-265b77153355>

¹⁵http://www.sud.mk/wps/portal/vsrn/sud/vesti/25d81d88-3f1f-4c76-a275-a3d3a06f8a60!/ut/p/z1/rVJNT8JAEP01PW5maOI2PS4EiigSBYtuhSz9gFW6LbAU9de7PZloLBic2yTvY97kgYAFCC0rtZZGFVpu7R4JuqRhu43sDu_Z5KmDvlcBm95wx4A8yZA2EcQzfxnECBibUqzgag8rrYqXuavDh6OiYNIeAdGSwer9GCUg66fSfBCGPGyVkbacUCJdAOfSc_xJNKMSYq1XhmrBKKL0PNzAev78ZfhNV-cg0TWlvivGA_6AfJZr-Vz9uiOuf1hpdITzHSxz-3LJ39MMPjh8C3E0L_SoVF-ckuvlB-e64gtobsfdUdrKyvNhiidFbC4SntS1ctuJ7gtWaFN-mZg8S8tK_NZrx3oj86DyTsrthpmuVzdvgegljVUG!/dz/d5/L2dBISEvZ0FBIS9nQSEh/?urile=wcm%3Apath%3A%2Fpublic_mk%2Fsud%2Fpocetna%2Fvesti%2F25d81d88-3f1f-4c76-a275-a3d3a06f8a60



PTHP ngriti akuzë për përpjekje për vrasje të deputetit Ziadin Sela

PTHP Shkup shpalli se te Gjykata Themelore Shkup 1 ka dorëzuar aktakuzë kundër dhjetë personave për veprën penale të kryer Vrasje sipas nenit 123 paragrafi 1 vv me nenin 19 vv me nenin 22 të KP-së. Sipas prokurorisë, të gjithë të akuzuarit të bashku, si edhe me persona të tjerë identiteti i të cilëve nuk është përcaktuar, janë përpjekur t'ia marrin jetën të dëmtuarit Sela, kështu që një pjesë e tyre kanë përdorur objekte të forta të cilat i kanë gjuajtur kah të dëmtuarit duke i shkaktuar lëndime të rrezikshme për jetën, kurse të tjerët duke përdorur goditje, shqelma shuplaka e kanë kryer veprën për të cilën akuzohen.

Prokurori publik kompetent nga PTHP Shkup me aktakuzën ka dorëzuar edhe propozim për vazhdim të masës paraburgim për nëntë prej të akuzuarve, kurse për një prej tyre propozim për vazhdim të masës paraburgim shtëpiak, sepse ekzistojnë baza se të akuzuarit mund të largohen, për ndikimin mbi dëshmitarët, si dhe për përfundim të veprës penale për të cilën janë akuzuar.¹⁶

PSP-ja ngriti procedurë për përcaktim të përgjegjësisë së gjykatëses Monika Bahçovanovska

Prokuroria Speciale Publike te Këshilli për Përcaktim të Fakteve ka dorëzuar ankesë për përcaktim të përgjegjësisë së Monika Bahçovanovskës nga Gjykata Themelore Shkup q, si gjykatëse në lëndën "Tifani", ku PSP-ja e ndjek gazetaren Ivona Talevska për fshehje të tatimit. Me këtë ankesë është kërkuar që të kontrollohet puna e saj në aspektin e ushtrimit joprofesional dhe të papërgjegjshëm të funksionit të gjykatësit. Sipas PSP-së, gjykatësja Bahçovanovska duke vepruar mbi ankesën e dorëzuar me propozim për ndarje të shkrimeve të lëndës të dëshmisë të mbledhur në mënyrë joligjore në lëndën për të cilën PSP-ka ka dorëzuar aktakuzë, më 11.09.2017 ka marrë vendim ku ka dhënë vendimin e Gjykatës së Apelit Shkup të miratuar më 18.09.2017, duke thënë se ky vendim është adaptuar, ose bëhej fjalë për një lloj tjetër të sjelljes me të cilën kryhet keqpërdorim i pozitës dhe tejkalim i autorizimeve zyrtare, nga aspekti se gjykatësja mund ta ketë ditur paraprakisht vendimin e Gjykatës së Apelit Shkup.¹⁷

Gjykatësi Nanev: Sistemi AKMIS në Gjykatën e Apelit Shkup ka funksionuar relativisht mirë

Gjykatësi Llazar Nanev, i cili është kryetar i grupit të punës në Ministrinë e Drejtësisë për kontroll të sistemit AKMIS për shpërndarje të lëndëve në gjykata deklaroi se kontrolli ka dëshmuar se në Gjykatën e Apelit Shkup mbajtja e regjistrave është kryer në mënyrë relativisht cilësore. Për dallim nga Gjykata Penale në Gjykatën e Apelit kanë vepruar nga tre gjykatës dhe bëhet fjalë një futje mjaft më të vogël të të dhënave elektronike. Nanev tha se pret që anëtarët e këtij grupi pune të bëjnë kontroll edhe në Gjykatën Themelore që të dalin së shpejti me raport përfundimtar mbi keqpërdorimet e mundshme të sistemit AKMIS në të tri gjykatat që ishin objekt i kontrollit.¹⁸

¹⁶<http://jorm.gov.mk/?p=4394>

¹⁷<http://www.jonsk.mk/?p=1305>

¹⁸<http://a1on.mk/archives/818899>



Këshilli Gjyqësor lejoi përsëritjen e procedurës kundër Mitrinovskit sipas aktvendimit të GJEPNJ-së

Pasi Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut ka marrë vendim me të cilin është vërtetuar shkelja e nenit 6 (e drejta e gjykimit të drejtë) nga Konventa, kurse në lidhje me procedurën për shkarkim të gjykatësit Jordan Mitrinovski, i cili në atë moment ka qenë kryetar i Gjykatës së Apelit në Shkup, Këshilli Gjyqësor lejoi përsëritje të procedurës kundër Mitrinovskit. Gjatë shkarkimit të tij, Këshilli ka përcaktuar se Mitrinovski ka vepruar në mënyrë të kundërligjshme kur e ka miratuar vendimin që Bajrush Sediu të lëshohet në paraburgim shtëpiak me një garanci të madhe në të holla.

Gjatë vitit 2017, Komisioni ka vendosur debate më 27.02.2017, 24.04.2017 dhe 11.05.2017, të cilat janë shtyrë me kërkesë të Mitrinovskit dhe të mbrojtësve të tij. Këshilli Gjyqësor ka formuar komision për zbatim të procedurë së përsëritur i cili ka caktuar seancë më 22.11.2017 dhe e cila është mbajtur në prani të dorëzuesit të kërkesës për përcaktim të ushtrimit joprofesional dhe të papërgjegjshëm të funksionit, ndërsa në mungesë të Mitrinovskit i cili është ftuar në mënyrë të rregullt.¹⁹

Profesionalizmi, ekspertiza dhe efikasiteti

Është promovuar matrica për matje të performancave në gjyqësor

Më 06.11.2017 është promovuar matrica për matje të performancave në gjyqësor, e përpunuar në bashkëpunim midis Ministrisë së Drejtësisë, Ambasadës Britanike dhe Qendrës për Hulumtime dhe Analiza Juridike (QHAJ). Ky mjet është përgatitur në bazë të analizave krahasuese mbi mekanizmat për matje të reformave në gjyqësor në shtetet evropiane dhe standardet ndërkombëtare në përputhje me CEPEJ dhe EU Justice Scoreboard. Ministri Saliji theksoi rëndësinë e kësaj Matrice për evalvim të plotësimit të qëllimeve të parapara në Strategjinë për Reforma dhe të Planit Aksionar në aspektin e planifikimit strategjik dhe krijimit të politikave, kështu që për herë të parë në gjyqësor në RM do të mundësohet vlerësim sistematik i reformave në bazë të kriterëve të qarta dhe të matshme.²⁰ Më 13.11.2017 u mbajt mbledhja e anëtarëve të Këshillit Gjyqësor me përfaqësuesit e QHAJ-së ku është biseduar mbi mënyrën se si do të zbatohet matrica e lartpërmendur, e cila përbëhet nga pesë fusha të

¹⁹http://www.vsrn.mk/wps/portal/ssrn/sud/vesti/e3197fd0-81b7-472b-8e1d-42e27de74738!/ut/p/z1/rVNNU9swFPwtHHyU9WIL7s1AQ5o2AYa6xLp4ZFt2XPAHtrBLf32VDjOdBJqUobq9mX379u1bQQnXUDZqrEplqrZR97aOpZ_4F4wh8RI9EYvzAIURo7Prq6-YcQZvdwEX-FJYwGXkB_MZiSIK5eH-b1BCmTWmMxsYD-2oTVLfoWh4zB3UtZk2jXLQqAdTOUhTHPAiR0DgIAPGSQqExjlgRBOea844FVu6LqtyGBeiyEiufJBqJQDLkAABURnAPmcxvThIN-X_1lfVj76ywwRc_8BgDxmznzw2Qu5yvHR4AWWV1u6U1S5yBaYeJcL3GGGC-3h7wbBJqSih7HWhe927j7097MaYbvjgIAdN0-SWbVveazdrawe91rJpBwPXu0gY2-X5H2WX8xm3yj5iLxTX5GZu3RkrPcGoafvaZunmjBexBHsT9vyb4dcm3J4tk6tPMMbbohmsGwTJb7QqtUsZ5dhDPhAU-8B6V4DA4xkoMFGbx3igPPJM-oYdDi-w8t5p0RF6_k76xbH42qRU3x8eZGj_cNsY_cOG5H98YstL-uXZOiawU2YDqqZo4fqfWrs6ggV9qsBdsTRe6pV1cn668sYViBfjz9MVkOnTFJ6c_AKKiU6j/dz/d5/L2dBISevZ0FBIS9nQS_Eh/?urile=wcm%3Apath%3A%2Fsovet_mk%2Fsud%2Fpocetna%2Fvesti%2Fe3197fd0-81b7-472b-8e1d-42e27de74738

²⁰http://www.pravda.gov.mk/novost_detail.asp?lang=mak&id=1405



punës: efikasitet, transparencë dhe përgjegjësi, drejtësi gjyqësore cilësore, pavarësi dhe paanësi, zhvillim profesional dhe përfaqësim përkatës.²¹

Punëtori dhe konferencë rajonale me ndërmjetësim të AGJPP “

Më 23 dhe 24.11.2017, Akademia për Gjykatës dhe Prokurorë Publikë “Pavell Shatev” në suazat e projektit “Përforcimi i kapaciteteve të gjyqësorit për mbrojtje të të drejtave të njeriut dhe luftës kundër veprimit çnjerëzor dhe ofendues dhe kundër mosdënimit” i financuar nga BE-ja, kurse është zbatuar nga Këshilli i Evropës organizoi takim të përfaqësuesve të katër gjykatave të apelit dhe të Këshillit Gjyqësor, ku u diskutua mbi nevojën e harmonizimit të praktikës gjyqësore, me theks mbi çështjet kontradiktore në fushën penale dhe gjyqësore.²²

Në suazat e projektit “Përforcimi i ekspertizës gjyqësore për lirinë e shprehjes dhe për mediat në Evropën Juglindore (JUFREX)” më 2 dhe 3.11.2017 në Budva, Mal i Zi u mbajt konferenca rajonale me temë “Liria e shprehjes dhe interneti”, ku morën pjesë gjykatës, prokurorë, avokatë dhe përfaqësues të projektit nga 6 vende (Republika e Maqedonisë, Serbia, Bosnja dhe Hercegovina, Mali i Zi, Kosova dhe Shqipëria).²³

II LUFTA KUNDËR KORRUPSIONIT

U kompletua dhe dorëzua dokumentacioni për ekstradim të Grujevskit dhe Boshkovskit

Gjykata Themelore Shkup 1 e informoi publikun se ka vepruar me kërkesë të Ministrisë së Drejtësisë së RM-së në lidhje me procedurën për ekstradim të Grujevskit dhe Boshkovskit, kështu që këshilli penal i Njësisë për Krim të Organizuar dhe Korrupsion e kompletoi dokumentacioni i nevojshëm dhe e ka dorëzuar te Ministria e Drejtësisë e RM-së për veprim të mëtejshëm.²⁴ Grujevski dhe Boshkovski të cilët

²¹http://www.vsrn.mk/wps/portal/ssrm/sud/vesti/fcdde36a-1b15-48fb-b260-73a222069584!/ut/p/z1/rVNNU9swFPwtHHyU9W3LrRoSNMmwFCXWBePbMuOC_7AFnbp6_SYaaTQJMyVLc3s2_fvn0rKOEaykaNValM1Tbq3tax9BLvgjEKpQmVYnEoDBidHZ99RUzn8HbXcAFvhQWcBI5wXxGoohCebj_G5RQZo3pzAbGQztqk9R3Dhoecwd1baZNoxw06sFUDiqyPNfUuWcnmAMmihSkxEPAP4oQgryAC7al67lqhzHKOeJexgDRSABGVAYUTTUl8olQnQvFGd2X_1LfVj76yvwRc_8BgDxmzW2Qu5yvHR4AWWV1u6U1S5yBaacEuFxrPjwPby9YNikVJRQ9rrQve7dx94edmNMN3xwklOmaXLLti3vtZu1tYNea9m0g4HrXSSM7fL-H2WX85lvIX3EPBTX5GZu3RkrPcGoafvaZunmjibexBHsT9vyb4dcm3J4tk6tPMMbbohmSgwTJb7QqtUsZ9TFHHhAUezZcfgEC7megwEQFnPmB4uSZ9A07HF5gxd9pORF6_530i2PxtUmpvj88yND-4bYx-ocNyf_4xJaX9MuzpU1gp8wGVE3RwvU_tXZ1VAv6VIG7Yml4yss6OT9d8XEF4sX483QFZPo0hScnvwAWRw38/dz/d5/L2dBISEvZ0FBIS9nQSEh/?uril=wcm%3Apath%3A%2Fsovet_mk%2Fsud%2Fpocetna%2Fvesti%2Ffcdde36a-1b15-48fb-b260-73a222069584

²²<http://www.ipacademy.gov.mk/novosti/----oe-a-o-->

²³<http://www.ipacademy.gov.mk/novosti/-----2-3--2017----->

²⁴http://www.sud.mk/wps/portal/oskopje1/sud/vesti/f9c20a3f-ff89-4eba-86c8-b2dc51f5d86d!/ut/p/z1/rVJdT8lwFP0tPuyx6WXsozwWM0AUiSLC-kK6boUK6waUKf56S2JionHDYN-anl97zz2Y4TlmmldqyY0qNN_Yf8yCRdD3PCC3cEcmj12gEYTKqUMBohDP6gD9HmBWz3_GDDOhTWIWOC4PyUaJRb52YH9IHSgLLkRnNHaiyvVEOyI5wgbclkpJ0kJclHJFAEJS4qfBb0k9JKJ70SqFSHJ-



MPB-ja i ka kërkuar pas kërkesës së miratuar së PSP-së nga gjykatësi në procedurë paraprake, gjenden në burgun për ekstradim në Selanik, Republika e Greqisë.

Urdhër për hetim kundër nëntë personave për keqpërdorim të pozitës dhe autorizimit zyrtar

PTHP Shkup ka miratuar Urdhër për zbatim të procedurës hetimore kundër nëntë personave për kryerje të veprave penale Punë e papërgjegjshme në shërbim sipas n.353 v. p.3 vv me p.1 dhe neni 353 b p.2 i KP-së, si dhe për veprën penale të kryer Keqpërdorim të pozitës dhe autorizimit zyrtar sipas n.353. p.3 të KP-së, n. 353 p 2 të KP-së, n.353 p.2.vv me nenin 23 5ë KP-së, n. 353 p.3 vv me p.1 dhe vv me nenin 23 të KP. Personat dyshohen se në vitin 2014 kanë vepruar në mënyrë të paligjshme gjatë marrjes së vendimeve në procedurat mbi kërkesat e dorëzuara për përcaktim të statusit juridik të objekteve joligjore, duke i shkaktuar dëm prej 4.100.090 denarësh, Prokurori publik kompetent i ka dorëzuar gjykatësit në procedurë paraprake edhe propozim për përcaktim të masave për sigurim të gjashtë të dyshuarve (ndalim për lëshim të vendbanimit, obligim që të paraqiten në gjykatë dhe marrje të dokumentit të udhëtimit).²⁵

Debat publik për propozim-ndryshimet dhe plotësimet ligjore të Ligjit për mbrojtje të denoncuesve

Më 21.11.2017 Ministria e Drejtësisë mbajti debat publik ku janë prezantuar ndryshimet dhe plotësimet në Ligjin për mbrojtjen e denoncuesve. Sipas anëtarëve të grupit të punës, qëllimi i tyre është harmonizimi me rekomandimet ndërkombëtare në këtë fushë si edhe tejkalimi i pasaktësisë dhe sigurimi i harmonizimit të brendshëm të dispozitave ligjore të cilat i përcaktojnë kanalet për denoncim të mbrojtur dhe për mbrojtje të denoncuesve.²⁶ Përndryshe, në procesin e ndryshimeve janë konsultuar edhe ekspertët e përfshirë në studimin “Kah Panoptikonit qytetar – ekuilibri më i mirë midis mbrojtjes së privatësisë dhe nevojës së ndjekjes së komunikimeve” e cila është përpunuar në suazat e projektit “Rrjeti 23+”.²⁷

Punëtori “Parandalimi i korrupsionit, përplasjes së interesave dhe mbrojtja e denoncuesve”

Punëtorja e cila u mbajt më 13 dhe 14.11.2017 në Shkup me organizim të KSHPK-së, në bashkëpunim me instrumentin TAIEX të Komisionit Evropian, dhe në partneritet me Agjencinë e Antikorrupsionit e Republikës së Italisë, ishte vazhdim i konferencës së mbajtur në korrik në samitin në Trieste si dhe pjesë e Procesit të Berlinit në luftën kundër korrupsionit dhe masat mbrojtëse kundër kësaj dukurie. Kryetari i KSHPK-së, dr. Tanturovski deklaroi se nuk ka dështime në ballafaqimin me korrupsionin në aspektin e

[FniUteJoffnkUPvk1ANaUH2uyYHUap4hjO0P4BRgPeiHQadTyKXlwx9SaVCp7xVNd7HJ708kflxr8cPi2xtC_0KFWfniTXCg_bDqCbbI62W4ZtVUstMneDJ7_SxetsLsbXY-Wdl5uVkhpWeD5WdQyn-akfvRoLUdR24uH1Xv3HrHk-EqvPgBhy1Xk/dz/d5/L2dBIS9nQSEh/?urle=wcm%3Apath%3A%2Fpublic_mk%2Fsud%2Fpocetna%2Fvesti%2Ff9c20a3f-ff89-4eba-86c8-b2dc51f5d86d](http://www.jorm.gov.mk/?p=4389)

²⁵<http://jorm.gov.mk/?p=4389>

²⁶http://www.pravda.gov.mk/novost_detail.asp?lang=mak&id=1409

²⁷http://www.merc.org.mk/Files/Write/00001/Files/Network23/studies/Kon-gragjanski-panoptikon-ramnoteza-pomegiu-sledenje-na-komunikaciite-i-privatnosta_MK.pdf



parandalimit. Luka Trifone nga Agjencia e Antikorrupsionit e Republikës së Italisë, theksoi se është shumë i rëndësishëm bashkëpunimi i Italisë dhe i shteteve të BE-së me shtetet e Ballkanit Perëndimor si në lidhje me shkëmbimin e përvojave në luftën kundër korrupsionit ashtu edhe në pjesën e njohjes së përbashkët me pritjet dhe nevojat në lidhje me punën në këtë plan, kurse përfundimet e kësaj konference, do të jenë pjesë përbërëse e Procesit të Berlinit.²⁸

Takimi midis KSHPK-së dhe Byrosë për Luftë Ndërkombëtare kundër Drogës dhe Zbatim të Ligjit

Nga fundi i muajit nëntor, Komisioni Shtetëror për Parandalim të Korrupsionit mbajti takim pune me përfaqësues të Zyrës Juridike të Byrosë për Luftë Ndërkombëtare kundër Drogës dhe Zbatim të ligjeve në Ambasadën e SHBA-së, ku morën pjesë kryetari KSHPK-së, dr. Igor Tanturovski, dhe disa anëtarë të tij, si dhe përfaqësues të Zyrës së Byrosë, të cilët u njohën me punën dhe kompetencat e Komisionit, veprimin në fushën e parandalimit të korrupsionit, të përplasjes së interesave, mbrojtjen e denoncuesve dhe veprimi gjatë periudhës zgjedhore si edhe për projektet dhe aktivitetet vijuese të Komisionit. Gjithashtu, u bisedua edhe për mbështetjen në suazat e reformës së sistemit juridik-penal në RM.²⁹

Diskutim i organizatave qytetare mbi luftën kundër korrupsionit

Delegacioni i Komisionit Evropian organizoi diskutim të shoqërisë qytetare në RM ku janë shqyrtuar tri tema kryesore: sundimi i të drejtës dhe lufta kundër korrupsionit, sfidat e organizatave qytetare dhe liria e mediave. Këtu është theksuar se veprimi i organizatave qytetare në luftën kundër korrupsionit është shumë e rëndësishme për zhvillimin e demokracisë në shtet, si dhe se organizatat qytetare momentalisht janë aktive në procesin e krijimit të politikave që dëshmon hapje të Qeverisë për bashkëpunim, por gjatë këtij procesi duhet të merren parasysh seriozisht edhe kapacitetet e organizatave qytetare sepse në një periudhë shumë të shkurtër kohore po miratohen një sërë dokumentesh dhe strategjish të reja në fusha të ndryshme.³⁰

PROCEDURA GJYQËSORE AKTUALE

LËNDA: “TRISTA” (KOK 40/17): Debati për këtë lëndë të PSP-së më 15.11. 2017 u shty për shkak të mungesës së të akuzuarit, kurse gjykimi i datës 27.11.2017 është shtyrë për më 01.12.2017 duke pasur parasysh gjendjen e rëndë shëndetësore në të cilën gjendet i akuzuari, i cili u paraqit në gjykim dhe e dha raportin mjekësor si dëshmi se merr medikamente kundër dhimbjeve dhe terapi kundër depresionit. Është paralajmëruar se në seancën e ardhshme do të ftohet edhe neuropsikiatër dhe mjek neurolog, të cilët duhet të japin mendimin e vet mbi gjendjen shëndetësore të pacientit.

²⁸http://www.transparency.mk/index.php?option=com_content&task=view&id=1238&Itemid=57

²⁹https://www.dksk.mk/index.php?id=19&tx_news_pi1%5Bnews%5D=519&tx_news_pi1%5Bcontroller%5D=News&tx_news_pi1%5Baction%5D=detail&cHash=d73e66ae7aa38679030e9bdde3855085

³⁰http://www.transparency.mk/index.php?option=com_content&task=view&id=1239&Itemid=57



LËNDA: “Trust” (K.nr. 1459/17): Gjykimi për këtë lëndë të PSP-së më 07.11.2017 është shtyrë pas fillimit sepse nuk i është dorëzuar lista e dëshmime mbrojtjes. Në seancën për debatin kryesor më 14.11.2017, kryetari i këshillit ka marrë vendim me të cili refuzohet kërkesa e mbrojtjes që seanca të shtyhet për shkak se nuk ka pasur mundësi për qasje te dëshmitë, me arsyetimin se dhënia e dëshmime do të vijojë pas fjalimeve hyrëse të palëve në procedurë ku ata do të kenë mundësi në procedurë kontradiktore ti hedhin poshtë ato dëshmi në përputhje me LPP. Pastaj iu dha fjala hyrëse PSP-së, kurse mandej edhe mbrojtësve të të tre të akuzuarve dhe të tre personave juridikë të akuzuar. Atyre u janë treguar të drejtat e tyre në procedurë dhe deklarimi për fajin. Për shkak të përgatitjes së mbrojtjes efektive dhe njohjen me dëshmitë seanca për procedurën dëshmuuese është shtyrë për më 21.11.2017, kur para fillimit të seancës, mbrojtja përsëri kundërshtoi para gjykatës në lidhje me dëshmitë e dorëzuara nga PSP-ja të cilat nuk kanë qenë të lexueshme ose kanë qenë të paqarta se për se bëhet fjalë, një pjesë e tyre kanë munguar, kurse një pjesë janë dhënë në gjuhë të huaj. Edhe pse dëshmitarët e thirrur në seancë janë propozuar nga mbrojtja, gjykata vendosi me vendim formal ata të pyeten si dëshmitarë të PSP-së.

Para fillimit të seancës së katërt (23.11.2017), mbrojtja ka reaguuar përsëri dhe ka apeluar që gjykata të lejojë që dëshmitarët e propozuar nga PSP-ja të pyeten drejtpërdrejt edhe nga mbrojtja, sepse në pyetjet e kryqëzuara mund të bëhen pyetje vetëm për faktet dhe rrethanat të cilat janë dhënë në pyetjet e drejtpërdrejta. Pas kësaj gjykata mori vendim me të cilin i lejohet mbrojtjes në pyetjet e kryqëzuara të bëjnë pyetje jashtë ose drejtpërdrejt. Me veprimin e tillë gjykata bëri një sërë gabimesh procedurale.³¹ Në seancën e pestë (30.11.2017) u bë marrja në pyetje e dëshmitarit të PSP-së, i cili është pyetur drejtpërdrejt, në mënyrë të kryqëzuar dhe shtesë. Për shkak të këtyre gabimeve procedurale, marrja në pyetje e dëshmitarit është kryer në një proces kaotik, ku janë bërë pyetje jashtë rregullave dhe mundësive të parapara ligjore.

LËNDA: “Transportues” (KOK.nr. 30/17): Seanca e 06.11.2017 u shty për shkak të mungesës së një prej të akuzuarve në këtë proces, për të cilën mbrojtësi i saj e tregoi dokumentacionin mjekësor. Seanca e ardhshme është caktuar të mbahet më 13.12.2017. Për shkak të numrit të madh të të akuzuarve në këtë proces dhe mundësia për shtyrjen e saj, nga Prokurorja speciale publike është kërkuar që gjykata të caktojë terma të tjerë për këtë lëndë me qëllim që të mos shtyhet për shkak se është e zënë në palë të tjera në procedurë, kurse në përputhje me parimet e procedurës penale. Si data të ardhme për këtë lëndë i ka përcaktuar 23.01.2018, 25.01.2018, 29.01.2018 dhe 31.01.2018.

LËNDA: “Lagjja e trimave” (KOK. nr. 127/15): Në seancë nga 02.11.2017, gjykata publikisht dhe gojarisht e shpalli dhe e arsyetoi vendimin për lëndën “Lagjja e trimave”. Të akuzuarit në këtë proces janë akuzuar për veprat e kryera penale në përputhje me nenin 394 a paragrafi 2 dhe 394 b paragrafi 1 i KP-së. Tridhjetë e tre të akuzuarit janë shpallur fajtorë, kurse katër janë çliruar nga akuza sepse prokuroria në këtë procedurë nuk arriti të dëshmojë akuzën për ta.

³¹Për më tepër detaje në këtë drejtim, shiko mendimin juridik të shpallur në faqen e Koalicionit “Të gjithë për gjykim të drejtë” që gjendet në këtë link: <http://all4fairtrials.org.mk/wp-content/uploads/2017/11/%D0%9D%D0%95%D0%B5%D0%B4%D0%BD%D0%B0%D0%BA%D0%B2%D0%BE%D1%81%D1%82-%D0%BD%D0%B0-%D0%BE%D1%80%D1%83%D0%B6%D1%98%D0%B0%D1%82%D0%B0.pdf>



Shtatë të akuzuarve u është shqiptuar dënim me burgim të përjetshëm, trembëdhjetë të akuzuarve – dënim me burg prej 40 vjetësh, gjatë të akuzuarve – dënim me burg prej 20 vjetësh, një të akuzuari – dënim me burg prej 18 vjet, dy të akuzuarve – dënim me burg prej 14 vjet, dy të akuzuarve – dënim me burg prej 13 vjet dhe dy të akuzuarve – dënim me burg prej 12 vjetësh. Përveç kësaj, në përputhje me nenin 33 të KP-së, gjykata të gjithë shtetasve të huaj u shqiptoi edhe dënimin e dëbimit të të huajit, përgjithmonë nga territori i RM-së. I autorizuari i të dëmtuarve është udhëzuar të realizojë kërkesën juridike-pronësore në çështje gjyqësore qytetare.

LËNDA: Procedura e ndarë për “Lagjia e Trimave” (KOK. nr. 95/16): Në seancën për shpalljen e vendimit të caktuar më 03.11.2017, i akuzuari është shpallur fajtor, kështu që gjykata i ka shqiptuar dënim me burg prej 10 vjetësh për veprën sipas nenit 394 a dhe dënim me burgim të përjetshëm për veprën sipas nenit 394 b. Në përputhje me KP-në gjykata ka shqiptuar dënim të veçantë me burgim të përjetshëm. Shpallja e vendimit nuk përmbante asnjë pasqyrim të veprës dhe dëshmime, as shkaqet për të cilat gjykata e ka marrë vendimin e tillë. Gjukata e ka lexuar shqiptimin e vendimit, kurse dëshmitë në bazë të të cilave është marrë vendimi janë thënë/numëruar shkurtimisht. Është shpallur se vendimi do të përgatitet në afatin ligjor prej 2 muajsh, kështu që publiku do të ketë mundësi të njihet me thelbin e dëshmime të dhëna kur publiku ka qenë i përjashtuar dhe do t’u vihet fund spekulimeve të pranishme në publik.

LËNDA: “Mito” (KOK. nr. 62/16): Seanca filloi gjysmë ore më parë se termini i caktuar pa u bërë informimi në kohë për këtë gjë, kështu që publiku është penguar të marrë pjesë. Vendi dhe koha e mbajtjes së gjykimit nuk është shpallur as para sallës së gjyqit ku duhej të mbahej seanca. Seanca është shtyrë sepse lënda gjendet në Gjykatën e Apelit, ku duhet të merret vendim në lidhje me ankesën për ndarje të dëshmime dhe kjo do të vazhdojë më 25.12. 2017.

LËNDA: “Bozhinovski” (KOK. nr. 79/16): Në seancë ishte i pranishëm PP tjetër, për shkak të mungesës së prokurorit i cili e udhëheq këtë lëndë, kurse i cili i ka informuar më parë të akuzuarin dhe mbrojtësin e tij për mungesën dhe janë marrë vesh që të shtyhet seanca. Edhe pse mbeti e paqartë se kush kërkoi formalisht shtyrje (mbrojtja apo PP-ja), gjykata mori vendim që seanca të vazhdojë më 12.12.2017.

LËNDA: “Sopot” (KOK. nr. 53/10): Seanca gjyqësore për seancën kryesore të caktuar më 23.11.2017 është shtyrë për më 20.12.2017 sepse dëshmitari i cili duhej të merrej në pyetje nuk kishte një dokument identifikimi të vlefshëm, kështu që nuk mund t’i përcaktohej identiteti.

LËNDA: “Kështjella 2” (K. nr. 1905/16): Para fillimit të seancës më 02.11.2017 mbrojtësi i të akuzuarve propozoi që seanca të shtyhet në një kohë të pacaktuar, me qëllim që të akuzuarit të mos i bëhet gjykim në mungesë, sepse i akuzuari është gjetur tashmë dhe është në paraburgim ekstradimi me kërkesë të Ministrisë së Drejtësisë. Ndaj këtij propozimi ishte kundër PSP-ja, sepse i akuzuari nuk ka qenë në dispozicion të organeve maqedonase të drejtësisë, madje edhe në rastin që i akuzuari të akuzohet, procedura do të përsëritet në mungesë të tij. Gjukata mori vendim me të cilin refuzohet mbrojtja, duke vlerësuar se nuk ekzistojnë kufizime as në Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut as në Ligjin për Ndhimë Ndërkombëtare në materialin penal kur për të akuzuarin ekziston procedura e ekstradimit.



Procedura vazhdoi me dhënien e dëshmime në plotësim të procedurës dëshmuuese, ku publiku është përjashtuar për shkak të dhënies së dëshmime të klasifikuara. Fjalët përfundimtare për këtë lëndë janë dhënë në seancën e mbajtur më 06.11.2017, më pas më 08.11.2017 është shpallur vendimi, me të cilin i akuzuari Goran Grujovski, ish-shef i DZK, që ngarkohet për veprat penale “Keqpërdorim i pozitës dhe autorizimit zyrtar” sipas nenit 353 paragrafi 5 v.v. paragrafi 1 v.v. neni 22 dhe “Falsifikim i dokumentit zyrtar” sipas nenit 361 paragrafi 1 i KP-së. Të njëjtit i është shqiptuar dënim me burg prej 1 viti e 6 muajsh, kurse të akuzuarit e tjerë kanë marrë dënim me kusht.

LËNDA: “Mariglen” (K. nr. 1271/16): Gjykimi i anëtarit të “Të Majtës” Mariglen Demirit, i akuzuar për pjesëmarrje në turmë gjatë shkatërrimit të zyrës së Presidentit Gjorgje Ivanov, është shtyrë për më 12.12.2017 pasi PP-ja ka dorëzuar dy procesverbale origjinale dhe mbrojtja kërkoi kohë me qëllim që të kryejë mbikëqyrje të tyre.

LËNDA: “Pavle” (K. nr. 1526/16): Seanca më 06.11.2017 është shtyrë për më 15.11.2017, pasi prokuroria kërkoi përsëri ekspertizë të re të dëmit mbi fasadën e Ministrisë së Kulturës të bërë gjatë “Revolucionit laraman” që duhej ta zbatonte Fakulteti i Ndërtimtarisë në UKIM. Me pranimin e kërkesës së tillë, gjykata bëri zbatim të gabuar të dispozitave të LPP-së.³² Dhe seanca e vendosur për më 15.11.2017 është shtyrë për shkak të ekspertizës së lartpërmendur kontestuese.

LËNDA: “Komuna Qendër”(K. nr. 1904/16): Në seancën 20.11.2017 një prej të akuzuarve e pranoi fajin, kurse shpallja e vendimit është vendosur për më 24.11.2017, seancë në të cilën ai mori dënim me kusht me burg në afat prej 6 muajsh i cili nuk do të zbatohet nëse i njëjti nuk kryen asnjë vepër tjetër penale në periudhë prej 2 vjetësh. Në seancën më 29.11.2017 edhe një prej të akuzuarve e pranoi fajin, kështu që PSP-ja kërkoi procedura për të të ndahet, më pas është marrë dhe është shpallur publikisht vendimi me të cilin ai është dënuar me dënim me kusht me burg prej 6 muajsh i cili nuk do të zbatohet nëse i njëjti nuk kryen asnjë vepër tjetër penale në periudhë prej 2 vjetësh.

LËNDA: “Rover” (K. nr. 2454/15): Është evidentuar komunikimi i papërshtatshëm ex-parte para fillimit të seancës, sepse PP-ja hyri në sallën e gjyqit në të njëjtën kohë me palët e tjera, por nëpërmjet hyrjes zyrtare, për të cilën reagoi mbrojtja. Për shkak të sëmundjes të një prej të akuzuarve, gjykimi u shty për më 29.01.2018 në orën 10:00.

III TË DREJTA THEMELORE

Avokati i Popullit

³²Për më tepër detaje, shiko mendimin juridik të shpallur në faqen e Koalicionit “Të gjithë për gjykim të drejtë” që gjendet në këtë link <http://all4fairtrials.org.mk/wp-content/uploads/2017/11/%D0%A1%D0%A3%D0%9F%D0%95%D0%A0%D0%92%D0%95%D0%A8%D0%A2%D0%90%D0%A7%D0%95%D0%8A%D0%95.pdf>



Në seancën e kuvendit të mbajtur më 06.11.2017, deputetët nuk i votuan masat që gjenden në raportin e Avokatit të Popullit ku janë vendosur rekomandimet e Raportit të Grupit Ekspert të Pribes për përmirësimin e gjendjes me të drejtat dhe liritë e njeriut në Maqedoni. Në përputhje me ndryshimet në Ligjin për Avokatin e Popullit, Kuvendi duhet ta miratojë raportin e tij dhe ta obligojë Qeverinë që t'i zbatojë masat e dhëna. Këtë vit ato, midis të tjerash, ishin edhe për përforcimin e mekanizmit të jashtëm kontrollues mbi punën e policisë dhe prokurorisë, ndërprerjen e përdorimit të plumbave prej gome dhe të paralizuesit elektrik si mjet për detyrim, përmirësimin e kushteve të burgut, përmirësimin e sistemit "Termini im" si dhe të regjistrimit në librat amë të fëmijëve pa identitet.³³

Në konferencën për shtyp, të mbajtur një ditë më pas, Avokati i popullit, Ixhet Memeti, deklaroi se do t'i dorëzohet masat për përmirësim të gjendjeve të përkeqësuar me të drejtat dhe liritë e njeriut të cilat ai i ka konstatuar në Qeveri dhe akuzoi për shkeljen të ashpër të ligjit, sipas të cilit Kuvendi duhet të jetë mbrojtës i Avokatit të Popullit. Ai theksoi se do të kërkojë nga Qeveria t'i vendosë këto masa në mbledhje dhe t'i obligojë organet shtetërore ta korrigojnë gjendjen, kurse pas gjashtë muajsh do të kërkojë që të informohet deri ku ka arritur realizimi i masave të propozuara.³⁴

Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut u bëri apel deputetëve të shumicës në pushtet që në afatin sa më të shkurtër të mundshëm t'i miratojnë masat që janë në raportin e Avokatit të Popullit, duke pasur parasysh se zbatimi i rekomandimeve të Raportit të Grupit Ekspert të udhëhequr nga Pribe duhet të jenë prioritet i Kuvendit dhe i Qeverisë që shteti ta përshpejtojë procesin e eurointegritimeve, por edhe më e rëndësishme është, të sigurojë mbrojtje efektive të të drejtave të njeriut dhe lirisë së qytetarëve.³⁵ Më 7.11.2017 rekomandimet e Avokatit të Popullit kaluan në Komisionin për Sistem Politik dhe u kthyen në fillim në procedurë të Kuvendit.³⁶

Gjatë këtij muaji, Avokati i popullit është takuar me përfaqësuesit e Komisionit Evropian, me të cilët bisedoi mbi punën e institucionit dhe sfidat aktuale pas miratimit të ndryshimeve në Ligjin për Avokatin e Popullit. Njëkohësisht u bë fjalë edhe për gjendjen me të drejtat e njeriut në shtet dhe zbatimin e rekomandimeve të tij nga organet e administratës. Përfaqësuesit e KE-së e mbështetën edhe njëherë punën e Avokatit të Popullit duke theksuar se është me rëndësi të jashtëzakonshme institucionit t'i mundësohet zbatim i përkryer i mandatit të tij të përgjithshëm, sepse institucioni i pavarur dhe tërësisht operativ për të drejtat e njeriut është segment veçanërisht i rëndësishëm për përparimin e shtetit drejt BE-së.³⁷

³³<http://24vesti.com.mk/naroden-pravobranitel-kje-bara-vladata-da-gi-sprovede-merkite-otkako-pratenicite-go-izignoriraa>

³⁴<https://sdk.mk/index.php/makedonija/memeti-pobara-od-vladata-da-gi-sprovede-merkite-za-chovekovi-prava-otkako-pratenitsite-gi-izignoriraa/>

³⁵<http://mhc.org.mk/announcements/660?locale=mk#.WiP5aEgnGUK>

³⁶<http://fokus.mk/pratenitsite-se-skontsentriraa-i-gi-vratija-preporakite-na-narodniot-pravobranitel-vo-sobraniska-protsedura/>

³⁷http://ombudsman.mk/mk/aktivnosti/241439/narodniot_pravobranitel_g_idzhet_memeti_ostvari_sredba_so_pr_etstavnici_na_evropskata_komisija.aspx



Më 27.11.2017 në kuadër të projektit “Rrjeti 23+” është mbajtur një punëtori tematike eksperte me temën “Avokati i Popullit - ndërmjet normës dhe së vërtetës”, ku u diskutua për një numër çështjesh relevante lidhur me funksionimin e këtij institucioni, në prani të Ixhet Memetit, ku kontributin e vet konstruktiv në diskutim dhanë përfaqësuesit e institucioneve kompetente shtetërore, organizatave qytetare dhe mediave të cilët për një periudhë më të gjatë e ndjekin punën e Avokatit të Popullit.³⁸

Liria e shoqërimit fetar

Me vendimin e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut të shpallur më 16.11.2017³⁹ është konstatuar shkelje e nenit 11 (liria e mbledhjes dhe shoqërimit) në lidhje me nenin 9 (liria e mendimit, vetëdijes dhe fesë) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, e cila ka dalë nga refuzimi i organeve kompetente që të regjistrohet Kryepeshkopata Ortodokse e Ohrit (AOO) si bashkësi e veçantë fetare. Për shkeljen e konstatuar, Republika e Maqedonisë është e obliguar t’i paguajë aplikuesit 4.500 euro (për dëm jomaterial) dhe 5.000 euro (për shpenzime dhe daljet).

Procedura në Strasburg është iniciuar me aplikim nr.3532/07 dorëzuar nga Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut në emër të “AOO” si shoqëri fetare. Të dyja kërkesat për regjistrimin e saj janë refuzuar nga gjykatat vendase për arsye formale, si dhe në dy baza të tjera – se shoqata është formuar nga një kishë e jashtme ose shtet, dhe se emri i saj i propozuar ka qenë problematik në aspektin se ka qenë shumë i ngjashëm me titullin e “KOM-Kryepeshkopata e Ohrit” e cila ka të drejtë historike në vazhdimësinë e përdorimit të këtij emri, kështu që shoqata ka pasur për qëllim të jetë institucion fetar paralel. Shoqata-aplikuese ka pasur dhe dy procedura pa sukses para Gjykatës Kushtetuese, e cila i ka refuzuar kërkesat për mbrojtje të lirive dhe të drejtave në bazë arsyeve formale të rrepta, pa u vendosur në mënyrë meritore sipas kërkesave të saj.⁴⁰

Të drejtat e punëtorëve

Pas dorëzimit të iniciativës për mbikëqyrje të jashtëzakonshme inspektuese nga Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut, Inspektorati Shtetëror i Pinës – NJR Dellçevë dëshmoi shkelje të të drejtave të punëtorëve në SHPTSH “Tekstil M SHPK” nga Makedonska Kamenicia. Pas inspektimit të kryer dhe marrjes së deklaratave nga të punësuarit, inspektori shtetëror i punës me vendim përcaktoi shkelje të dispozitave të Ligjit për Marrëdhënie Punë në mënyrën e dhënies së pagës nga punëdhënësi dhe i dha afat për largimin e shkeljeve të konstatuara. Komiteti i Helsinkit e përshëndeti vendimin e tillë dhe informoi se edhe mandej do ta monitorojë këtë rast, në aspektin se a ka vepruar brenda afatit të dhënë sipas vendimit të inspektorit.⁴¹

³⁸<http://mhc.org.mk/announcements/674?locale=mk#.WiP7LEqnGUK>

³⁹[https://hudoc.echr.coe.int/eng#{"documentcollectionid2":\["GRANDCHAMBER","CHAMBER"\],"itemid":\["001-178890"\]}](https://hudoc.echr.coe.int/eng#{).

⁴⁰<http://mhc.org.mk/announcements/666?locale=mk#.WiP7JUqnGUK>

⁴¹<http://mhc.org.mk/announcements/669?locale=mk#.WiQUmUqnGUK>



Mbrojtja e të dhënave personale

Drejtoria për Mbrojtjen e të Dhënave Personale e ka miratuar Strategjinë e re për zbatim të të drejtës për mbrojtje të të dhënave personale (2017-2022)⁴², si dokumenti i dytë strategjik në këtë fushë, i cili e përshkruan gjendjen e sistemit për mbrojtjen e të drejtave personale në nivel nacional, dhe e shpreh nevojën dhe vizionin që të kihet një qasje e tërësishme dhe moderne në mbrojtjen e të drejtës së njeriut mbi mbrojtjen e të dhënave personale nëpërmjet vendosjes së sistemit për parandalim, respektim dhe kuptim të të drejtave dhe obligimeve. Ajo jep edhe sfidat e reja, parimet themelore të pavarësisë dhe të nevojës për një kuadër profesional, transparent dhe të kualifikuar në këtë Drejtori.

Njëkohësisht, Ministria e Drejtësisë e përgatiti propozim-ligjin për ndryshime dhe plotësime të Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, qëllimi i të cilit është përforcimi i statusit të pavarur të Drejtorisë nga ndikimet politike dhe ndikimet e tjera në përputhje me kërkesat e Nënkomitetit për Drejtësi dhe Siguri si dhe me Raportin e Pribes, si dhe raportet për përparim të RM-së për vitin 2015 dhe 2016, si dhe në drejtim të harmonizimit me dispozitat e ligjit të ri LPPA.

Mbrojtja nga diskriminimi

Komisioni për Mbrojtjen nga Diskriminimi konstatoi përmbajtje diskriminuese në artikullin me titull “Ciganët në udhëkryq janë gjithnjë e më të shumtë dhe më të dhunshëm”, të transmetuar në edicionet informative të TV “Alfa”, ku Komisioni e pranoi ankesën e AVMU-së se televizioni ka nxitur dhe përhapur diskriminimin ndaj romëve në bazë të përkatësisë etnike dhe përkatësisë në një grup të marginalizuar.

Në bazë të kësaj, nga TV “Alfa” është kërkuar në afat prej 30 ditësh nga marrja e rekomandimit t’u kërkojnë falje publikisht Romëve si grup i marginalizuar, dhe nëse televizioni nuk e kryen këtë Komisioni ka të drejtë të ngrejë iniciativë para organit kompetent për përcaktim të përgjegjësisë, kurse Agjencia ka të drejtë të ngrejë padi para Gjykatës Themelore Shkup 2 për kompensim të dëmit. Në përgjigjen dërguar Komisionit, nga Tv “Alfa” deklaruan se me vendim të kolegjiut të redaksisë gazetari dhe redaktori i lajmeve janë dënuar me 20 për qind të rrogës gjatë 3 muajve.⁴³

⁴²https://dzlp.mk/sites/default/files/dzlp_strategija_mk.pdf

⁴³<http://novatv.mk/alfa-ke-mora-da-im-se-izvini-na-romite-za-diskriminatsija-vo-vestite/>